



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /  
Ministry of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE  
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU  
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe Mënyrën e Pagesës së Trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, shpall:

## THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

### Trajnimi i Trajnerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Qëllimi i këtij trajnimi është të përgatisë dhe të certifikojë trajnerë të kualifikuar për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mira. Trajnimi synon të pajisë pjesëmarrësit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të udhëhequr dhe zhvilluar sesione trajnimi për institucionet publike në Kosovë, duke siguruar që të dhënat personale të trajtohen me kujdesin e duhur dhe të mbrohen nga çdo lloj keqpërdorimi. Përmes këtij programi, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të thellojnë kuptimin e tyre për principet themelore të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të aplikojnë këto njohuri në kontekstin e trajnimeve që do të ofroj IKAP-i.

Programi do të përfshijë kombinim të trajnimit në aspektin teorik dhe praktik, lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, seanca mbi shkathtësitë prezantuese. Përveç kësaj, gjatë programit kandidatët për trajnerë do të përfshihen në mësim duke u angazhuar drejtpërdrejt në aspekte praktike sa i përket zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe praktikave ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në fund të procesit, pritet që trajnerët të jenë në gjendje të mbajnë vetë trajnim të barasvlershëm për vlerësimin Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke përdorur vetë dizajnin e programit dhe materialet.

### Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Trajnimi për Trajnerë TpT pritet të mbahet në muaji tetor 2024

**Vlerësimi i kandidatëve:**

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë periudhës dhe pas përfundimit të trajnimit.

**Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:**

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës (përparësi kanë zyrtarët e fushës);
- Përvoja në trajnime;
- Elementet tjera të meritës, publikime në fushën e mbrojtjes së të dhënave,

**Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:**

Kandidatët e suksesshëm do të angazhohen si trajner sipas nevojave të programit të Trajnimit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve: 09.09.2024 deri me 23.09.2024.

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i kufizuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një **letër motivimi** (deri në **250 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe.

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: [besart.mulaj@rks-gov.net](mailto:besart.mulaj@rks-gov.net), duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

**Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në CV tuaj mund të kërkohen për verifikim.**